

Veprime të gjendjes civile

Lindje

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Akti i lindjes së fëmijës, lëshuar nga autoritetet e huaja, i legalizuar ose pajisur me vulë apostillë;
- 2) Përkthimi i aktit të lindjes, i legalizuar ose pajisur me vulë apostillë;
- 3) Pëlqimi me deklaratë noteriale të prindit të huaj, nëse ka, për lejimin e regjistrimit të fëmijës në Shqipëri;
- 4) Dokumente identifikimi, pasaportë e vlefshme udhëtimi ose letër njoftimi, të prindërve.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja e dokumenteve me prezencë personale ose me postë;
- 2) Verifikimi i rregullshmërisë së dokumentacionit nga sekretari i shtetit me vule apostile;
- 3) Përcjellja zyrtare e aktit të lindjes së fëmijës.

Ose: Bëhet me Prokurë duke autorizuar të afërmit për të bërë regjistrimin.

Tarifa e shërbimit dhe afati

Pa tarifë. 3 muaj

Zyra: Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime: Deklarata noteriale mund të formulohet para konsullit (shih aktet noteriale). Përkthimi mund të bëhet në përfaqësinë diplomatike dhe konsullore (shih përkthimi i dokumenteve).

Të gjitha shpenzimet që rezultojnë për përkthimin dhe përpilimin e deklaratave noteriale, kryhen përmes transferimeve bankare.

Akti i lindjes së spitalit, pa emër fëmije (bebe) certifikohet nga autoritetet kompetente (legalizim ose apostilim).

Martesa

A. Lidhja e martesës në Ambasadë

Dokumentacioni i nevojshëm kur bashkëshortët e ardhshëm janë me shtetësi s hqiptare:

1. Certifikatë për lidhje martese (marrë në gjendjen civile përkatëse në Shqipëri dhe e legalizuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme Tiranë); sejcili
2. Kopje e kartës së identitetit; sejcili
3. Pasaportë ose dokumente të rregullta qëndrimi në SHBA (p.sh. leje qëndrimi Green Card).

Dokumentacioni i nevojshëm kur njëri nga bashkëshortët është i huaj:

1. Leje martese e vërtetuar sipas rastit në zyrën përkatëse. Në rast se shtetasi n uk është amerikan, leja e martesës duhet të vërtetohet nga Ambasada përkatëse e vendit të huaj;
2. Certifikatë lindje e vërtetuar ose pajisur me vulën Apostille;
3. Pasaportë amerikane ose me lejen përkatëse të qëndrimit të rregullt në SHB A.

Dokumentet për lidhje martese kanë afat vlefshmërie deri në 3 muaj.

Paraqitja personale dhe dëshmitarët

Për lidhjen e martesës është e nevojshme prania personale e dy bashkëshortëve . Ata duhet të shoqërohen secili me një dëshmitar, të cilët nuk mund te jene familjare. Ata duhet të kenë me vete dokumente identifikimi dhe të jenë me qëndrim të rregu llt në SHBA.

Lëshimi i aktit martesor

Lidhja e martesës në Ambasadë konfirmohet me aktin martesor. Tarifa e lëshi mit të aktit është 45\$. Kjo shumë duhet të derdhet paraprakisht në llogarinë bankare të ambasadës.

Duhet të kihet parasysh që dokumentet nuk duhet të jenë më të vjetra se 3 muaj. Gjithashtu dokumentet duhet të jenë paraprakisht të legalizuara me vule Apostile.

Për marrjen e dokumenteve të nevojshme në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri shtetasi/shtetasja shqiptar/e mund të paraqitet vetë zyrën e gjendjes civile atje ose mund të autorizojë me prokurë një njeri të afërm. Ambasada nuk mund të sigurojë dokumente të zyrës së gjendjes civile si certifikata, leje martes e,etc

B. Lidhja e martesës në Shqipëri nga te huajt

Dokumentet që duhet të paraqiten në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri nga shtetasi huaj:

1. Certifikatë për lidhje martese; Dokument nga Bashkia e qytetit ku banon (City Hall) që është beqar
2. Certifikatë lindje;
3. Dokument që vërteton banimin në SHBA.

Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të mos jenë më të vjetra se 3 muaj dhe duhet të jenë legalizuara paraprakisht me vule Apostille nga sekretari i Shtetit.